

Titulli i lëndës: MJEKËSIA SOCIALE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/ Dega:Mjekësi e Përgjithshme/Katedra e Mjekësisë sociale
Titulli i lëndës:	Mjekësi Sociale
Niveli:	Bachelor/ Studime të integruara
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i IV-të Semestri i VIII-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	Fakulteti i Mjekësisë
Mësimdhënësi:	Prof.Dr Merita Berisha
Të dhënat kontaktuese:	merita.berisha@uni-pr.edu 038 551 431 lok:1037 Konsultimet: e Hëne në IKSHPK prej orës 8:00-9:00
Përshkrimi i lëndës:	Ky modul njohton konceptet bazike të shëndetit dhe mbrojtjes shëndetësore, zhvillimit të mbrojtjes shëndetësore në vendin tonë dhe në botë, metodologjinë e matjes së shëndetit, masat e prevencës, strukturat dhe proceset e promovimit të shëndetit, parandalimit, diagnostikimit, terapisë kuruese, si dhe paliative, kujdesit dhe rehabilitimit nga sëmundjet akute në ato kronike dhe faktorët më të rëndësishëm të cilët ndikojnë në shëndet, karakteristikat themelore të gjendjes shëndetësore të popullatës, pabarazite e gjendjes shëndetësore, sëmundjet, gjendjet dhe grupacionet me rëndësi socialo mjekësore. Njohuri themelore për menaxhmentin në shëndetësi, sistemin e sigurimit shëndetësor dhe social, ekonomikën shëndetësore, sistemin e informimit shëndetësor, vendin dhe rolin e mjekësisë familjare në mbrojtjen shëndetësore të popullatës, promovimin dhe edukimin shëndetësor, bashkëpunimin ndërkombëtar në shëndetësi si dhe organizimin e mbrojtjes shëndetësore dhe shërbimit shëndetësor në rastet e jashtëzakonshme.
Qëllimet e lëndës:	Detyrat themelore të mësimin nga mjekësia sociale, lëndë që përmes teorisë dhe praktikës mundëson t'i njohtoj studentët me aspektet socialo mjekësore të shëndetit të individit dhe bashkësisë të cilët jetojnë në kushte të caktuara të rrethit të ndikuar nga faktorët socialo ekonomik, biologjik dhe fizik, metoden socialo mjekësore me masat e prevences, primare, sekondare e terciare si dhe organizimin e mbrojtjes dhe sistemit shëndetësor.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij moduli studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojë shëndetin, sëmundjen dhe modalitetet e sëmundjes, ndërveprimin e individit me shoqërinë dhe mjedisin • të vlerësojë dhe krahasojë gjendjen shëndetësore të popullatës dhe faktorët që ndikojnë në te përmes indikatorëve të shëndetit; • t'i identifikojë problemet prioritare dhe të propozojë masat për përmirësimin e gjendjes shëndetësore; • të formoj mendimin i cili do t'i mundësoj që në punën e tij të ardhshme ta vështroj bashkësinë si tërësi; • të kontribuojë në drejtim të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit dhe me sjelljen e vet të shërbejë si shembull; • të gjejë informacionin përkatës, lidhë atë me njohuritë nga fushat e tjera dhe zbaton në mënyrë krijuese këtë për të zgjidhur problemet • të kuptojë nevojën e qasjes multidisciplinare dhe punës në ekip.
--	--

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	1/15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike	2	1/14	28
Konsultime me mësimdhënësin			
Puna në terren	1	1/1	1
Testi, punimi seminarik	2	2/2	4
Detyrë shtëpie	2	½	2
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1/10	20
Përgatitja për provimin final	2	5	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	3	3
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2

Total		100
Metodat e mësimdhënies:	<i>Ligjerata, ushtrime përmes punës në grupe, seminare, mësimi i vetëdrejtuar.</i>	
Metodat e vlerësimit:	<p>Provimi final bëhet përmes provimit me test. Pragu i kalueshmërisë është 51%. Pyetjet mund të jenë me një ose më shumë përgjigje të sakta dhe pyetje ku studenti duhet me e përshkruar/plotësuar përgjegjen.</p> <p>Kohëzgjatja e provimit 1 orë. Studenti vlerësohet me notën përfundimtare e cila është rezultat i vlerësimit të përgjithshëm.</p>	
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Ligjëratat të përgatitura nga Prof.Dr Merita Berisha</i> 2. Sistemet Shëndetësore/Transition in Health and Health Care in Kosovo-Prof.Ass.Dr.Merita Koçinaj, Fatime Arënlju –Qosaj 2010 3. Konceptet e ligjerimeve, libri ne dorëshkrim 4. Edukimi Shëndetësor”- Ilir Begolli 2001 5. Th.H.Tulchinsky, E.A. Varonikone. The New Public Health. Second Edition, 2014 6. V.Bijegovic, D.DOnev: “Health systems and their evidence based development”, 2004 7. G. Pavlekovic et all.: Health promotion and disease prevention, 2014 8. Public health textbook - HealthKnowledge UK : Department of Health, 2009 9.Socijalna Medicina – Želimir Jakšić, Luka Kovačić i suradnici 2000 	
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. European Observatory on Health Systems and Policies http://www.euro.who.int/observatory/Publications/20020522_2 2. WHO, Regional Eu. http://www.euro.who.int/en/about-us/regional-director/speeches-and-presentations-by-year/speeches-and-presentations?root_node_selection=145221 3. EPHO, WHO.: http://www.euro.who.int/en/health-topics/Health-systems/public-health-services/policy/the-10-essential-public-health-operations 4. Health Sectorial Strategy 2017-2021, Ministry of Health, Republic of Kosovo, 2017 5. Promoting health –Linda Ewles Ina Simnett 2003Maidenhead : McGraw-Hill / Open University Press, 2007 	

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrja, njoftimi me lëndën (prezentimi i Syllabusit) Definicioni dhe lënda e studimit të mjekësisë sociale dhe shëndetit publik
Java 2:	Shëndeti dhe determinantat e tij, mbrojtja shëndetësore dhe zhvillimi i kujdesit shëndetësor në vendin tonë dhe në botë
Java 3:	Pabarazitë në gjendjen shëndetësore
Java 4:	Karakteristikat e gjendjes shëndetësore në vendet e pazhvilluara dhe të zhvilluara, Shëndeti global
Java 5:	Metodologjia e matjes së shëndetit të banorëve Indikatorët e shëndetit Indikatorët demografik
Java 6:	Indikatorët e morbiditetit Indikatorët e ambientit të jashtëm Indikatorët e veprimtarisë shëndetësore
Java 7:	Kriteriumet për vlerësimin e rëndësisë sociale mjekësore të çshtjeve shëndetësore Metoda sociale mjekësore për përcjelljen, hulumtimin dhe analizimin e sëmundjeve, dukurive dhe grupacioneve të caktuara të popullatës.
Java 8:	Organizimi i mbrojtjes shëndetësore Sistemi shëndetësor dhe nënsistemet e tij Principet themelore të organizimit të mbrojtjes shëndetësore
Java 9:	Organizimi i mbrojtjes shëndetësore dhe shërbimit Sistemi shëndetësor dhe nënsistemet e tij Nivelet e ofrimit të kujdesit shëndetësor

	<p>Koncepti i mjekësisë familjare në mbrojtjen shëndetësore të popullatës</p> <p>Sistemi shëndetësor në rastet e jashtëzakonshme</p>
Java 10:	Roli dhe rëndësia e spitaleve, llojet e tyre dhe mënyra e organizimit
Java 11:	Burimet njerëzore në sistemin shëndetësor
Java 12:	<p>Menaxhmenti në shëndetësi, ekonomika shëndetësore</p> <p>Organizimi i financimit dhe sigurimit shëndetësor</p> <p>Sistemi i informimit shëndetësor</p>
Java 13:	<p>Planifikim në shëndetësi</p> <p>Zhvillimi dhe implementimi i planeve dhe programeve</p> <p>Përcaktimi dhe vendosja e prioriteteve</p> <p>Llojet dhe fazat e planifikimit</p>
Java 14:	<p>Koncepti dhe rëndësia e promovimit dhe edukimit shëndetësor</p> <p>Metodat dhe mjetet edukativo shëndetësore</p>
Java 15:	<p>Rekapitulimi i lëndës dhe ligjerata përmbledhëse.</p> <p>Vlerësimi dhe diskutimi lidhur me detyrat në klasë dhe në shtëpi gjatë semestrit dhe përgatitja për provimin final.</p>

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ligjeratat duhet të vijohen së paku 75%. Nëse studenti mungon më tepër se dy ushtrime, seminare ose nuk është aktiv gjatë mësimit, duhet të hyj në kolokvium. Mbrojtja e seminarit është kusht për hyrje në provim. Studenti nuk pranohet në provim pa ID.

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.